

EDUART CAKA

**VAKËFET DHE FUNKSIONI I TYRE NË QYTETIN
E ELBASANIT GJATË SHEKULLIT XVII**

Hyrje

Studimi i historisë së qyteteve shqiptare gjatë Mesjetës ashtu si shumë tema të tjera që kanë lidhje me këtë periudhë mbetet si një domosdoshmëri për studiuesit e kësaj fushe. Studimet e deritanishme janë të përqendruara kryesisht në lidhjet ose marrëdhëniet ushtarake e politike të shqiptarëve gjatë kësaj periudhe me shtetet përreth. Aspekt i cili plotëson anën e jashtme të kornizës. Ndërsa studimi i qyteteve në vetvete do të nxirrte në pah edhe shumë elementë të tjerë me rëndësi të madhe sa i përket gjendjes ekonomike, politike, sociale, demografike, kulturore e fetare të hapësirës shqiptare gjatë këtyre shekujve.

Zhvillimet gjatë shek. XV dhe pushtimi i Shqipërisë nga ushtritë osmane solli ndryshime rrënjësore tek shqiptarët si në aspektin administrativ, ashtu edhe në atë ekonomik e kulturor. Njëri ndër impaktet më kryesore të periudhës së pushtimit ishte ai mbi zonat e banuara e kryesisht qytetet. Kështu, shumë qytete e kështjella të zhvilluara siç mund të përmendet Drishti, Deja, Sfetigradi e qendra të tjera u shkatërruan dhe shumë fshatra u braktisën masivisht nga banorët e tyre.¹ Ngjarjet në fjalë do të sjellin një ndërprerje të zhvillimit të qyteteve e veçanërisht të ekonomisë të cilat do ta nisin ringritjen e tyre vetëm pas një shekulli. Rrënimi apo braktisja e shumë zonave të banimit nga ana tjetër do të sjellë ndërtimin e zonave të reja të banimit apo zhvillimin e atyre ekzistuese në bazë të nevojave të pushtuesit. Një shembull i mirë i këtij aspekti është dhe rindërtimi i fortesës së rrënuar që gjendej afër lumit Shkumbin, një pikë e rëndësishme strategjike mbi rrugën e famshme Egnatia.

¹ *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 548.

a. *Themelimi i qytetit të Elbasanit*

Qyteti i Elbasanit u themelua në verën e vitit 1466 prej sulltan Mehmetit II² mbi rrënojat e një vendbanimi të hershëm.³ Procesi i rindërtimit u bë nga ushtria osmane gjatë rrethimit të dytë të Krujës, ku burimet historiografike tregojnë se në krye të punimeve kishte qëndruar vetë sulltani duke i motivuar punëtorët që ta mbaronin ndërtimin sa më shpejt.⁴ Duke u nisur nga kronikat e kohës që bëjnë fjalë mbi ngjarjen në

² Aşık Paşazade, *Osmanoğulları'nın Tarihi*, Çev. Kemal Yavuz ve M. A. Yekta Saraç, MAS Matbaacılık, İstanbul: 2003, f. 251; Edhe Biemmi shkruan mbi vendimin e sulltan Mehmetit për të ndërtuar një fortesë të cilën urdhëroi të ndërtohej në një kohë të shkurtër. Shih: Giammaria Biemmi, *Istoria di Giorgio Castrioto detto Scander-Begh*, Brescia: 1756, f. 455; Franz Babinger, *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas und der Levante*, v. I, Schmidt & Klaunig Kiel, München: 1962, f. 203; *Burime të zgjedhura për historinë e Shqipërisë*, vëll. II, përgatitur nga Aleks Buda, Injac Zamputi, Kristo Frashëri, Petraq Pepo, Universiteti Shtetëror i Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1962, f. 345-346; Autorë të ndryshëm e quajnë Valm vendin mbi të cilin u ndërtua fortësia nga ana e osmanëve. Shih: Vexhi Buharaja, "Rreth mbishkrimeve të fortësës së Elbasanit", në *Studime për epokën e Skënderbeut*, vëll. II, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 504; *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. I, Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2002 f. 452; Shuteriqi paraqet kronika të ndryshme duke u nisur nga autorë bizantinë, shqiptarë dhe osmanë siç mund të përmenden Sfrances, Barleti, Biemmi, Ashik Pashazade, Dursun Beu e të tjerë duke i krahasuar të dhënat në to mbi datën dhe vendin e ndërtimit të fortësës në fjalë. Për më shumë shih: Dhimitër S. Shuteriqi, *Moti i madh; Përmbledhje shënimesh e dokumentesh për historinë shqiptare të viteve 1379-1479*, Tiranë: Dituria, 2006, f. 324-327; Edhe studiuesi Kristo Frashëri jep të dhëna nga kronistë të kohës në lidhje me rindërtimin e qytetit. Shih: Kristo Frashëri, *Skënderbeu; Jeta dhe Vepra*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë: Toena, 2002, f. 432-435.

³ Bëhet fjalë për një qendër urbane të hershme, e cila është përmendur me emrin *Skampeis* (Scampia, Skampini) që në shek. II p.e.s. Për më shumë të dhëna mbi periudhat e hershme të qytetit, dukjen e tij në shkrimet e autorëve antikë dhe pozitën e rëndësishme gjeografike në të cilën qyteti ishte ndërtuar shih: Hasan Ceka, "Nga historia e lashtë e Skampinit (Elbasanit)", në *Studime historike*, nr. 1, Tiranë: 1975, f. 147-151.

⁴ Njëri ndër kronistët bizantinë të kohës, Kristobuli, i cili ka shkruar edhe një vepër për sulltan Mehmetin të titulluar "Historia e Mehmetit të Dytë" e përshkruan me këto fjalë angazhimin e sulltanit në ndërtimin e ndërtesës, e cila do të përfundonte në një kohë të shkurtër: "*Dhe sapo erdhi vera, filloi me nxitim dhe shumë forca e shpenzime dhe me dëshirën e kujdesin e sulltanit, dhe gjendej kudo vetë i pranishëm në punimet, duke shpjeguar çdo gjë dhe duke i nxitur të gjithë një pjesë me fjalë, të tjerët i bënte të gatshëm për këtë duke u ofruar të holla. Dhe pa dalë vera, arriti ta ndërtonte*

fjalë, studiues të shumtë japin mendimin që fortesa u rindërtua brenda një kohe shumë të shkurtër.⁵ Në përfundim ai ia vendosi emrin qytetit “Ilbasan”, emër që reflektonte pozitën e rëndësishme të qytetit.⁶

Një dokument i rëndësishëm në lidhje me ndërtimin e fortesës së Elbasanit, pozicionin gjeografik dhe rëndësinë që ajo kishte për osmanët është vetë letra e shkruar nga Sulltan Mehmeti II për djalin e tij Bajazitin. Versioni origjinal i kësaj letre gjendet në Bibliotekën Nacionale të Vjenës dhe që është prezantuar tek studiuesit shqiptarë nga studiuesi Dhimitër S. Shuteriqi në vitin 1964. Mehmeti II i shkruante të birit mbi rëndësinë e Elbasanit duke u shprehur se: “*për të siguruar pushtimin tonë mbi këtë vend, në një pikë, që na u duk më e përshtatshme, ndërtuam një kala madhështore, të pajisur me kulla të larta dhe mure e bedena të fuqishme. Këtë e caktuam si kryeqendër të vendit...*”⁷

pozicioni gjeografik i qytetit të Elbasanit e bënte këtë të fundit një qendër me rëndësi strategjike.⁸ Qyteti ndërtohej në një pikë lidhëse midis pjesës veriore dhe asaj jugore të trojeve shqiptare. Gjithashtu, zona në fjalë përshkohej nga rruga e famshme Egnatia, e cila lidhte Romën me Konstandinopojën dhe që për shumë shekuj me radhë kishte qenë pikëkalimi i udhëtarëve, mbretërve, ushtrive e karvaneve tregtare të ndryshme.⁹ Kjo gjeografi përbënte një nyje të rëndësishme pikëtakimi për rrugët tregtare që bashkonin qytete me tregje të mëdha ekonomike siç

kështjellën...” Shih: *Burime tregimtare bizantine për historinë e Shqipërisë (shek. X-XV)*, përgatiti Koço Bozhori - Filip Liço, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1975, f. 348-349.

⁵ Në lidhje me kohën në të cilën është bërë rindërtimi ka variante të ndryshme por mendohet që mund të ketë zgjatur 30 ditë. Për më shumë kronistët e kohës dhe variantet e tyre në lidhje me ndërtimin e fortesës shih: V. Buharaja, “Rreth mbishkrimeve të fortesës ...”, f. 515-516.

⁶ Në lidhje me emrin e qytetit shih: Aşık Paşazade, *Osmanoğulları'nın Tarihi ...*, f. 251; *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 452; K. Frashëri, *Skënderbeu; Jeta dhe Vepra ...*, f. 434.

⁷ Shih: Dhimitër S. Shuteriqi, “Një letër e sulltan Mehmetit II e vjeshtës 1466”, në *Mësuesi*, viti IV, nr. 16, Tiranë, 17 prill 1964; Dh. Shuteriqi, *Moti i madh...*, f. 330.

⁸ Milan Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat e Shqipërisë, kryesisht në Mesjetë*, përgatiti për botim Luan Malltezi, Tiranë: Onufri, 2009, f. 72.

⁹ Për më shumë të dhëna në lidhje me rrugën Egnatia dhe vendet në të cilat ajo kalonte shih: *Historia e popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 166; Mbi rrugën Egnatia gjatë luginës së Shkumbinit shih: Valter Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri*, Tiranë: Toena, 1997, f. 19-23.

ishte Ohri, Dibra, Durrësi apo Berati.¹⁰ Përveç rrjetit të brendshëm tregtar pozicioni i Elbasanit është përdorur edhe nga karvanet tregtare që merreshin me eksporte përmes portit të Durrësit. Të gjitha këto elementë favorizues përbënin një potencial të madh për zhvillimin e ekonomisë së qytetit ashtu edhe për shpërndarjen e prodhimeve të tij në një rrjet tregtar shumë të gjerë.

Me një largësi vetëm dyzet milje larg detit, Elbasani përbënte një rrezik të madh për pushtimin e Durrësit dhe pjesëve të tjera të bregdetit shqiptar që nuk ishin në duart e osmanëve.¹¹ Për këtë arsye, pozicionimi i pushtesit në një pikë kaq të afërt me brigjet e shqetësonte edhe Republikën e Venedikut, e cili sipas dokumentave ndërmori disa hapa konkretë për eliminimin e këtij rreziku potencial. Madje, dokumentat tregojnë se në gusht të vitit 1466 Senati i Venedikut merr vendim për t'u drejtuar Skënderbeut me qëllim ndërmarrjen e një ekspedite ushtarake të përbashkët për të penguar ndërtimet në Valm.¹² Po në një dokument tjetër, dogu i Venedikut Moro i shkruan Pal Engjëllit duke i kërkuar këtij të fundit të bashkojë forcat me kushëririn e tij Skënderbeun, për të

¹⁰ Zija Shkodra, *Qyteti shqiptar gjatë Rilindjes Kombëtare*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1984, f. 233.

¹¹ *Dokumente të shekujve XVI-XVII për historinë e Shqipërisë*, v. III (1603-1621), përgatitur nga Injac Zamputi, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1989, f. 45; V. Buharaja, "Rreth mbishkrimeve të fortesës ...", f. 513-514.

¹² Në vendimin e senatit të Venedikut shkruhej: "Dita XVI gusht. Të gjithë ata që shkruajnë nga Shqipëria e quajnë si një gjë të rrezikshme e të dëmshme për shtetin tonë në Shqipëri, rindërtimin që po i bën Turku atij qyteti të quajtur Valmi, qoftë për afërsinë e tij me vendet tona, qoftë edhe për shumicën e materialit për të ndërtuar fustet dhe anijet e tjera dhe për lehtësi të zbresë në për lum dhe të bjerë në det. Prandaj, duke qenë e nevojshme që të merren të gjitha masat e duhura nga çdo anë, të merret vendim që t'i shkruhet të madhërueshmët zotit Skënderbej, që të ketë mirësinë të marrë parasysh çështjen se ajo murtajë, që mund të thuhet se gjindet në gjirin e tij dhe tonin, do të bëhet çdo ditë më e dëmshme dhe më e rrezikshme. Gjithashtu, le t'u shkruhet proveditorëve tanë të Shkodrës dhe të Shqipërisë, se për këtë çështje duhet të takohen me Skënderbeun e lartpërmendur dhe t'i kuptojnë mendimet e tij, dhe t'i kujtojnë atij se do të na pëlqejë shumë dhe do të mbetemi fare të kënaqur në qoftë se ai merr guximin..., dhe, pasi të mblidhen të gjithë njerëzit tanë vendas dhe italikë, këmbësorë e kalorës, bashkë me të gjitha trupat ushtarake tia... të mund të sulmohet ai vend dhe, pasi të zbohen turqit, të rrënohet..." Shih. *Burime të zgjedhura...*, f. 346-347; Dh. Shuteriqi, *Moti i madh...*, f. 328-329; V. Buharaja, "Rreth mbishkrimeve të fortesës ...", f. 514.

sulmuar qytetin “Valma” që ishte restauruar nga turqit dhe ta rrënojnë përfundimisht atë.¹³

Si një pikë lidhëse e rrugëve tregtare Elbasani arriti një zhvillim të madh në një kohë shumë të shkurtër. Studiuesit por edhe kronistët e kohës theksojnë brenda një shekulli Elbasani arriti të bëhej njëra ndër qendrat ekonomike më të zhvilluara të vendit.¹⁴ Kështu, Shuflaj citon një italian i cili e viziton qytetin në vitin 1570 duke e përshkruar atë me këto fjalë:

“qyteti shtrihet në një fushë me ujë të bollshëm, ka mure të forta, pirgje katërkëndëshe dhe një hendek; rreth e përçark ka shumë lagje të jashtme. Për t’u dalluar nga qytetet e vjetra të Shqipërisë, frankët e quanin atëherë “Terra nuova”, grekët Neokastro.”¹⁵

Në këtë kontekst vlen të citohet dëshmia e ambasadorit venecian Bernardo i cili në vitin 1591 theksonte se në Elbasan ishte selia e sanxhakbeut. Veç të tjerash ai dëshmon për ekzistencën e një tregu lëkurësh e leshrash dhe të dy karvansarajesh në qytet.¹⁶ Pra, në një distancë të shkurtër kohore prej vetëm një shekulli Elbasani kishte nisur të merrte pamjen e një qendre të rëndësishme ekonomike, administrative e kulturore krahasuar me qytetet me të cilat rrethohej.

b. Zhvillimi ekonomik, demografik dhe kulturor i qytetit

Të dhënat burimore tregojnë se në shek. XVII qyteti i Elbasanit ishte njëra ndër qendrat më të rëndësishme të trojeve shqiptare.¹⁷ Kjo dëshmohej nga udhëtarë të ndryshëm që kanë vizituar zonën gjatë periudhës në fjalë, nga regjistrat osmane të kohës por edhe relacione të ndryshme që gjenden në arkivat perëndimore. Në lidhje me këtë të fundit,

¹³ Vlen të theksohet fakti se në letrën e sipërcituar dogu i Venedikut Moro, e quan Pal Engjëllin si kushëri të Skënderbeut. Për më shumë shih: Dh. Shuteriqi, *Moti i madh...*, f. 330.

¹⁴ Zija Shkodra, *Esnafet Shqiptare (shek. XV-XX)*, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 1973, f. 31.

¹⁵ M. Shuflaj, *Qytetet dhe kështjellat ...*, f. 72; Për një version më të gjatë i të njëjtit përshkrim shih: F. Babinger, *Aufsätze und Abhandlungen zur Geschichte Südosteuropas ...*, f. 208.

¹⁶ Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 31.

¹⁷ Studimet tregojnë se në shek. XVII Elbasani kishte 28 lagje me rreth 4 000 shtëpi. Një shifër më e madhe se qendra të tjera të rëndësishme të hapësirës shqiptare siç mund të përmenden Prizreni me 3 620 shtëpi, Berati me 2 000 shtëpi, Shkodra me 2 000 shtëpi etj. Për më shumë të dhëna në lidhje me popullsinë e qyteteve gjatë kësaj periudhe shih: *Historia e popullit shqiptar...*, vëll. I, f. 550; Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 46-47.

vlen të përmendet një relacion që dërgonte peshkopi i Stefanisë Nikolla Mekajshi për papa Klementin VIII ku theksohej se Elbasani ishte njëra ndër provincat më të rëndësishme të Shqipërisë. Letra e cila i përket shek. XVII e cilëson qytetin si qendër sanxhaku, me një popullsi të madhe ku vetëm pjesa e varoshit kishte rreth shtatë mijë shtëpi.¹⁸

Çelebiu e tregon Elbasanin si qendër të sanxhakut, me një administratë të fuqishme dhe që kishte nën varësi zona të rëndësishme përreth ku mund të përmenden Bashtova, Myzeqeja dhe Durrësi. Me 526 katunde, 18 zeamete dhe 128 timarë Elbasani në shek. XVII rezulton si një qendër e fuqishme ekonomike e administrative.¹⁹ Përsa i përket përmasave të qytetit Çelebiu rrëfen se vetëm brenda fortesës ndodheshin 460 shtëpi. Bashkë me lagjet që gjendeshin në periferi që sipas tij shtriheshin deri në një orë larg, Elbasani kishte 1150 saraje dhe shumë shtëpi të nivelit mesatar.²⁰

Në Bibliotekën Kombëtare të Bullgarisë është gjetur një regjistër osman i qytetit të Elbasanit që u përket viteve 1642-1643.²¹ Regjistri në fjalë është prezantuar tek studiuesit shqiptarë nga Thoma Kaçorri dhe përmban një listë të taksës së xhizjes që mbledhej nga banorët e krishterët të këtij qyteti. Nga këto të dhëna del në pah se vetëm brenda në qytet kishte 134 familje të krishtera. Ndërsa në fshatrat e nahijes së Elbasanit të cilat gjenden të regjistruara të radhitura gjenden 1153 familje të krishtera me emrat e kryefamiljarëve. Të dhënat e sipërpërmendura paraqesin

¹⁸ *Dokumente të shekujve XVI-XVII...*, f. 45-46.

¹⁹ Evlija Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh*, përkthyer nga Sali Vuçiterni, Shtëpia Botuese Besa, Tiranë: 2000, f. 90-91.

²⁰ Në lidhje me lagjet e varoshit të qytetit të Elbasanit, Çelebiu shkruan se kishte tetëmbëdhjetë lagje të banuara nga myslimanët e dhjetë të tjera që banoheshin nga pjesëtarët e komunitetit të krishterë. Ndërsa, në lidhje me përkatësinë etnike të popullsisë së Elbasanit, ai shprehet se aty nuk kishte “çifutë, frengj, armenë, serbë e bullgarë.” Shih E. Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh...*, f. 92-94; Emrat e lagjeve të Elbasanit gjatë kësaj periudhe ishin: Lagja Çeribashi, Çausli, Kazan Bej, Hurdhe, Xhami Qebir, Haxhi Zade, Spahi, Gjeda, Haxhi Iljas, Xhami Sherif, Gjevan Bej, Hasinedar, Sinan Aga, Iskender Bej, Dervish Bej, Tabakhane, Haxhi Sulejman, Zaranikë, Haxhi Hysen, Sinan Balli, Lagja e Re, Lagja e Jevgjëve, Memi Nazar, Soufiler, mahmut Aga, Xhevari, Kala, Zeraat. Shih: Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 46.

²¹ Thoma Kacorri, “Një regjistër Osmano-Turk i vitit 1642-1643”, në *Studime historike*, nr. 3, Tiranë: 1966, f. 165.

rëndësi onomastike por edhe demografike e kulturore përsa i përket Elbasanit gjatë shek. XVII.²²

Në aspektin ekonomik Elbasani njohu zhvillim në një kohë të shkurtër duke u bërë njëra ndër qendrat më të zhvilluara ekonomike të kohës. Shkaku kryesor i kësaj rritjeje ishte pozicioni gjeografik i qytetit i cili kryente funksionin e një nyjeje lidhëse midis Lindjes e Perëndimit, veriut e Jugut të qyteteve shqiptare. Studiuesit theksojnë se përveç tregut të brendshëm ku pazari i Elbasanit thithte prodhimet e qyteteve të tjera të zonës së Shqipërisë së Mesme, ky treg lidhte gjithashtu edhe portin e Durrësit me Maqedoninë dhe Thesalinë, por edhe me tregje më të largëta si ai i Sofjes apo Stambollit.²³ Pozicionimi mbi rrugën e vjetër Engatia i jepte mundësi tregtisë të prodhuar në Elbasan të lidhej si me tregun e brendshëm të perandorisë që kulmonte në kryeqendrën e saj Stambollin, ashtu edhe të paraqiste produktet e veta në detin Adriatik përmes portit të Durrësit.²⁴ Një fakt tjetër i rrjetit të gjerë tregtar që qyteti i Elbasanit kishte gjatë kësaj periudhe është edhe prania e tregtarëve të huaj herë pas here në këtë treg. Kështu, të dhënat burimore tregojnë për ardhjen në këtë qytet të tregtarëve grekë, armenë, hebrenj e të kombësive të tjera.²⁵

Një element tjetër tregues i rritjes ekonomike të Elbasanit ishin edhe panairët vjetore në të cilat ekspozoheshin prodhimet e zonës. Ndryshe nga shumë qytete të tjera, Elbasani ishte ndër të paktat zona që zhvillonin tre panairë lokale në vit.²⁶ Ky aspekt, ishte një tregues tjetër i rritjes

²² Në regjistrin e sipërpërmendur fshatrat e nahijes së Elbasanit në të cilat jetojnë të krishterët radhiten si: Shtemaji, Ulma, Petreshi, Shingjoni, Balteza, Buhulla, Preça e sipërme, Preça e poshtme, Brenesh, Mollagjesh, Rrilla, Shalës, Mansi, Godolesh, Bërxell, Mikull, Huhaqi, Shëngjergj, Labinot, Prapanik, Sërnica, Shëmill, Urumqe, Gjurakuqi, Akluqi, Zgovishte, Liborashi, Dragostoina, Lezvuç, Hotolishte, Kokreva, Vullçan, Buzgar, Skrocka, Bishkash, Prrënjës, fshati qyqes, Hudër, Dardhë, Babja, Miraka, Gura e Zez, Martanesh, Kostene dhe Ljubnik. Për më shumë të dhëna mbi numrin e shtëpive të krishtera që kishte secili fshat dhe emrave të kryefamiljarëve shih: Th. Kacorri, "Një regjistër osmano-turk...", f. 165-173.

²³ Stavri Naçi, "Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme dhe të Jugut sipas një dokumenti të shekullit të XVII-të", *Buletin për Shkencat Shoqërore*, nr. 2, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë: 1957, f. 229; Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare ...*, f. 31; Valter Shtylla, *Rrugët dhe urat e vjetra në Shqipëri*, Tiranë: Toena, 1997, f. 73.

²⁴ Zija Shkodra, "Esnafet (korporatat) në jetën qytetare ballkanike të shek. XVII-XVIII", në *Studime Historike*, n. 1, Tiranë: 1975, f. 167.

²⁵ S. Naçi, *Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme ...*, f. 224.

²⁶ Tre panairët e Elbasanit ishin ai i Shën-Gjon Vladimirit që mbahej më 22 maj, i Shën-Illisë më 20 korrik dhe i Shën-Mrisë më 15 gusht. Panairët zgjasnin nga disa ditë deri

ekonomike dhe potencialit tregtar që Elbasani kishte arritur gjatë periudhës në fjalë, ku, përveç kapacitetit prodhues të brendshëm ai thithte edhe prodhimet e qyteteve të tjera përreth si Kavaja, Durrësi e Kruja por edhe qendrave më të largëta siç mund të përmendet Berati, Dibra apo Manastiri.²⁷ Duke patur parasysh faktin se zona e Elbasanit me fshatrat përreth ishte e favorshme për zhvillimin e blegtorisë, dy panairët e parë që zhvilloheshin në maj dhe korrik kishin më shumë një karakter bujqësor e blegtoral ku paraqiteshin prodhimet e zonës.²⁸ Ndërsa panairi i tretë i cili zhvillohej në muajin gusht ishte më i madhi dhe aty tregtoheshin mallrat e esnafëve. Për këtë arsye, panairi i tretë pritej me festime nga ana e korporatave.²⁹

Veç panaiereve që karakterizoheshin nga një pjesëmarrje më e gjerë në Elbasan mbahej edhe tregu javor që zhvillohej çdo të dielë. Sipas udhëtarit osman Evlia Çelebiut këtë ditë qyteti mbushej me njerëz që vinin nga katundet, krahinat e fortesat përreth. Ai thekson se pjesëmarrja në treg është aq e madhe rruga mezi çahet për të kaluar. Me rëndësi është edhe përshkrimi që ai u bën rrugëve të qytetit duke theksuar se ato ishin të shtruara me kalldrëm ku në të dy anët kishte rrugë të posaçme për këmbësorë dhe në skaj të tyre gjendeshin kanale apo vija uji të cilat shërbenin për të larë, pastruar e flladitur rrugët.³⁰

Përveç pozitës gjeografike, një faktor tepër i rëndësishëm që i dha zhvillim të madh qytetit të Elbasanit gjatë kësaj periudhe padyshim ishte

në javë dhe përfitimi përllogaritej deri në 50 000 aspra. Shih: Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 31; V. Shtylla, *Rrugët dhe urat...*, f. 72; Zija Shkodra, "Kontribut për historinë e panaiereve shqiptare", në *Studime historike*, nr. 4, Tiranë: 1977, f. 164.

²⁷ V. Shtylla, *Rrugët dhe urat...*, f. 74.

²⁸ Në një dokument që flet mbi udhëtimin tregtar drejt Venedikut të një personi të quajtur Dhimitër nga Elbasani, del në pah se si eksport në tregun venedikas ai kishte dërguar prodhime blegtorale, lëkurë e dyllë. Ky aspekt e nxjerr edhe një herë në pah aspektin blegtoral për të cilin shquhej zona në fjalë. Shih: S. Naçi, *Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme ...*, f. 232.

²⁹ Z. Shkodra, *Historia e panaiereve...*, f. 168. Evlia Çelebiu shprehet kështu për këtë panair: "Në këtë panair bëhet një tregti e madhe. Prodhimet e shkarkuara aty, nga të katër anët, kushtojnë më shumë se pesë thesare të Egjiptit. Frytën më të madh e më të dobishëm të këtij panairi, i cili vazhdon dhjetë ditë e dhjetë netë e korr populli i Elbasanit, i cili e feston si ditë e Kurban Bajramit." Shih: E. Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh...*, f. 101.

³⁰ E. Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh...*, f. 96-97.

edhe institucioni i esnafëve ose korporatat.³¹ Organizimi i tregtareve të të njëjtave zeje në korporata ishte një motor i rëndësishëm zhvillimi si për vetë esnafët ashtu edhe për qytetin ku ato bënë pjesë. Gjurmët më të hershme dhe embrionike të organizimeve esnafore në Elbasan datojnë që në vitet 1580 ku bëhet fjalë për disa profesione më të zhvilluara siç mund të përmenden ato të tabakëve, papuçinjve, shpataxhinjve leshpunuesve, etj.³² Pas fazës së formësimit esnafet do ta arrijnë kulmin e zhvillimit të tyre në shek. XVII duke funksionuar brenda një sistemi të kodofikuar. Bie në sy fakti se sistemi i esnafëve të Elbasanit rezulton të jetë njëri ndër më të hershmit si në hapësirën shqiptare, ashtu edhe në pjesën ballkanike të perandorisë osmane.³³ Kështu, statuti i tabakëve daton në vitin 1657, ai i argjendarëve më 1662³⁴ dhe ai i gëzoftarëve në vitin 1669. Ato ishin të organizuara në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, me statute³⁵ e rregullore të veçanta³⁶, me përgjegjësi e detyra edhe në jetën qytetare.

³¹ Duhet theksuar fakti se ekzistenca e korporatave në hapësirën shqiptare nuk është një fenomen që i përket vetëm periudhës osmane. Të dhënat burimore, por edhe ato historiografike tregojnë për praninë e institucioneve të tjera duke nisur që nga shek. XIII. Kështu, në vitet e përmendura në qytete si Durrësi apo Shkodra gjenden organizime zejtarësh apo tregtarësh në formën e korporatave që rezultojnë të emërtuara si “Scuola” ose “Frataglia”, të cilat ishin të lidhura me rrjetet tregtare raguziane apo venedikase. Gjatë periudhës së sulmeve të ushtrive osmane mbi hapësirën e qyteteve osmane këto institucione do të dobësohen e humbasin. Pra, institucionet e esnafëve që u zhvilluan në shek. XVII nuk ishin fenomene të reja për shqiptarët, por ndryshonin nga struktura, madhësia dhe impakti që ato kishin në zhvillimin e qyteteve. Për më shumë shih: Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 82-84.

³² Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 84-85.

³³ Zija Shkodra, “Statuti ma i vjetër i esnafëve në krahinat e Ballkanit nën sundimin turk”, në *Studime historike*, nr. 2, Tiranë: 1965, f. 120-123.

³⁴ Për më shumë të dhëna mbi esnafin e argjendarëve të Elbasanit, regjistri i të cilave daton midis shek. XVII-XIX shih: S. Naçi, *Të dhëna mbi Shqipërinë e Mesme...*, f. 222; *Historia e Popullit shqiptar ...*, vëll. I, f. 553.

³⁵ Statuti i plotë i esnafit të tabakëve të Elbasanit, i cili mban datën 14 maj 1657 është përkthyer dhe publikuar nga Zija Shkodra. Për tekstin e plotë të statutit në fjalë shih: Z. Shkodra, *Statuti ma i vjetër ...*, f. 126-133.

³⁶ Në sherijet e Elbasanit (regjistrat e gjykatës) gjenden shumë vendime në lidhje me probleme të hasura midis tregtarëve të të njëjtit esnaf të cilat kanë shkuar para gjyqit. Kështu në një dokument që daton në vitin 1610 disa shpatandreqës të qytetit të Elbasanit paraqiten para gjykatës dhe padisin kolegë të të njëjtin profesion me argumentimin se këto të fundit mundohen t’u prishin mendjen klientëve duke u thënë se mund të jua rregullojnë thikën ose shpatën me një çmim më të ulët se ai normal. Kështu, gjykata vendos gjobitjen me 500 akçe për ato tregtarë që do të bëjnë shkelje të

Çdo korporatë kishte drejtuesit e saj por edhe bajrakët (flamurët) si shenjë dalluese.³⁷ Duhet theksuar se korporatat nuk ishin vetëm angazhim i popullsisë myslimane. Në qytete të ndryshme kemi raste kur esnafe të ndryshme si ato të bakërshinjeve apo kujumshinjeve (argjendarëve) ishin të komuniteteve të tjera fetare. Në rastin e Elbasanit, mund të thuhet se kishte një traditë të rëndësishme të esnafëve ortodoksë kodikët e të cilëve miratoheshin nga mitropolitë lokale.³⁸

Sa u përket korporatave që vërehen në qytetin e Elbasanit gjatë periudhës në fjalë, mund të thuhet se ai ishte qendra më e madhe shqiptare e esnafëve me 30 të tilla në të cilat përfshiheshin mbi 60 zeje të ndryshme.³⁹ Në këndvështrimin tonë, ky aspekt përbën njërin ndër shkaqet themelore të zhvillimit të qytetit të një periudhë kaq të shkurtër dhe kulmimit të kësaj zone në shek. XVII duke u kthyer në njërin ndër qendrat më të rëndësishme të hapësirës shqiptare në aspektin ekonomik, administrativ e kulturor. Për ta bërë më të qartë rolin dhe peshën që esnafet kishin në jetën sociale dhe ekonomike të qytetit, duhet theksuar se drejtuesit e këtyre esnafëve në të njëjtën kohë ishin edhe pjesë e aristokracisë së Elbasanit.⁴⁰

ngjashme. *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F) 129, Dosja (më tej: D) 2, Fleta (më tej: fl.) 11.

³⁷ Në fondin “Lef Nosi” pranë Arkivit Qendror të Shtetit gjejmë shumë të dhëna në lidhje me esnafet, qytetin e Elbasanit, familjet e rëndësishme të qytetit etj. Në lidhje me bajrakët e esnafëve të esnafëve të qytetit dhe rëndësinë e tyre dokumentat tregojnë të dhëna si: “*Në qytet ishte bajraku i esnafit të madh i cili ishte i terzivet edhe bajraktari ishte terzi. Pas ati ishte i tabakëve. Bajraku i terzivet asht në pëllhurë të bardhë, ka në të një dorë të kuqe të kapme edhe një shpatë po të kuqe. Ai i tabakëve asht në pëllhurë jeshile të mëndafshhtë shkruie në të ajete të kuranit. Në majet ka një bisht kali të cilin populli e beson për flokë prifti vramë në luftë të Bashtovës. Ky bajrak konsiderohet si ma i shejtë se asht ma i vjetri e ka ra në luftra të ndryshme. Bajraku i terzivet përdoret edhe me përcjellë e me pritë haxhillarët qi shkojnë në haxh. Ashtu edhe kur shkonin nizamë... Bajrake kanë edhe teqet e rufaive etj...*” Për më shumë të dhëna në lidhje me bajrakët e esnafëve shih: *AQSH*, F. 32, K. 1, D. 35-36, fl. 110-17, Poza 60, xh. 15.

³⁸ Z. Shkodra, *Esnafet në jetën qytetare...*, f. 84, 171; Në artikullin tonë mbi të drejtat e grave në Shqipëri gjatë shek. XVII-XVIII kemi theksuar se shumë gra e vajza ortodokse ishin të angazhuara në rrjetin esnafor duke trashëguar edhe punët e prindërve të tyre. Për më shumë shih: Eduart Caka, “Disa të dhëna mbi rolin dhe të drejtat e gruas në Shqipëri gjatë shekujve XVII-XVIII”, *Studime historike*, n. 1-2, Tiranë: 2015, f. 84-85.

³⁹ Z. Shkodra, *Esnafet në jetën qytetare...*, f. 169.

⁴⁰ Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare ...*, f. 219.

Zhvillimi demografik dhe ekonomik i qytetit u shoqërua edhe me ndryshime në aspektin kulturor. Sigurisht që një shkak tjetër që ndikonte në formësimin kulturor të qytetit gjatë kësaj periudhe ishte edhe besimi i ri, Islami. Elementë kulturorë të motivuara nga besimet myslimane dhe ortodokse do të kenë influencë në objekte të ndryshme si objektet e kultit, afresket e kishave e të bazilikave dhe lëvrimin e artit gojor ku në Elbasan dëshmohet për praninë e poetëve të ndryshëm.⁴¹ Kështu, kronisti i famshëm turk i shek. XVII Evlija Çelebi është një tjetër autor i cili na jep të dhëna mbi qytetin e Elbasanit gjatë shekullit në fjalë. Përveç këtij epiteti ai na jep edhe një emër tjetër të elbasanit si “Daru’sh Shuara” që do të thotë vendi ose shtëpia e poetëve.⁴² Ky aspekt nxjerr në pah edhe anën e zhvilluar kulturore e veçanërisht poetike të këtij qyteti. Të rëndësishme në këtë përshkrim gjithashtu janë edhe aspekte të ndryshme të qytetit si lagjet, arkitektura, vende ose ndërtesa të rëndësishme, tregu i qytetit, figura dhe familje të njohura të kohës etj. Nga të dhënat që Çelebiu jep rreth qytetit mund të veçohet ekzistenca e tre instituteve bamirësie për të varfërit e të huajt, shkollave të ndryshme, shtatë kafehane, tri banja, 430 kroje e shumë puse.⁴³

Ai gjithashtu jep të dhënat mbi tiparet, veshjet e zakonet e banorëve të Elbasanit duke i cilësuar si njerëz të shëndetshëm. Çelebiu dëshmon se gjuha e përdorur në qytet është arbërishtja, njihet edhe turqishtja, ndërsa tregtarët dijnë edhe greqisht e frengjisht. Atij i bën përshtypje bukuria e qytetit por edhe e banorëve të tij. Për këtë Çelebiu e cilëson qytetin e Elbasanit si “nusen e Shqipërisë dhe të Rumelisë.”⁴⁴

c. Roli i vakëfeve në zhvillimin e Elbasanit gjatë shek. XVII

⁴¹ Përveç monumenteve arkitekturore me karakter fetar që hasen gjatë kësaj periudhe vlen të përmenden zhvillimet e mëdha në aspektin e ikonografisë. Kjo, për vetë faktin se shek. XVI është shekulli i Onufër Neokastritit i cili ka arritur majën e ikonografisë pasbizantine duke e vulosur stilin e tij në shumë kisha kryesisht në Berat dhe Elbasan. Në Elbasan mësojmë që ai ka kryer punime në kishat e Shën Mërisë në Shpat, Shën e Premtes në Valsh dhe në atë të Shën Kollit në Shelcan. Për më shumë shih: *Historia e Popullit Shqiptar ...*, f. 717-718.

⁴² Në lidhje me praninë e dijetarëve e shkrimtarëve në Elbasan Çelebiu se: “*Elbasani është qytet i moçëm dhe i famshëm, është djep i shumë dijetarëve, poetëve e njerëzve kompetentë, me dije të plota, aftësi të pakufishme e të specializuar në zanatet e tyre.*” Shih: E. Çelebi, *Shqipëria: para tre shekujsh...*, f. 94, 101.

⁴³ *Po aty*, f. 96-99.

⁴⁴ *Po aty*, f. 88.

Siç u theksua edhe më sipër Elbasani si qendër urbane u zhvillua në një kohë shumë të shkurtër. Njëri ndër faktorët që ndikuan pozitivisht në përmirësimin e infrastrukturës, ekonomisë, mirëqenies dhe shërbimeve sociale ishte edhe institucioni i vakëfeve. Qytetet paraqesin ndryshime nga njëra tjetra duke u spikatur në sajë të disa avantazheve që mund të jenë gjeografike, kulturore, ekonomike apo administrative e strategjike. Kështu, gjatë kësaj periudhe Elbasani del në qendër të vëmendjes për zhvillimin e aspektit tregtar, konkretisht sistemit të esnafëve. Në këtë kontekst, vlen të theksohet fakti se në dokumentat e shumta që kemi mundur të konsultojmë në Sherijet e Elbasanit që gjenden pranë Arkivit Qendror të Shtetit vërehet se një pjesë e madhe e vakëfeve kishin lidhje të drejtpërdrejta me këtë kategori.

Në vetvete esnafet kishin edhe vakëfe me anë të të cilave mund të kontribuonin për ndërtime objektesh kulti, për ndihmesën e shtresave të ndryshme shoqërore që ishin në nevojë, për rregullime apo meremetime rrugësh, çezmash apo kanalesh. Kështu, nga dokumentat mësojmë se pothuajse të gjitha esnafet që vërehen në qytetin e Elbasanit kanë vakëfet e tyre. Shumica e të dhënave janë në lidhje me korporatat të cilat kishin më shumë anëtarë siç mund të përmenden ato të terzijve, tabakëve (lëkurëregjësve), shpatandreqësve etj. kështu, janë të shumtë personat të cilët japin donacione në favor të vakëfit të esnafëve pjesë e të cilës ato vetë ishin.⁴⁵ Kontributi i vakëfeve në ndërtimin e objekteve të ndryshme por edhe si pasojë e rëndësisë së tyre në jetën ekonomiko-sociale të qytetit vërehet edhe në toponimet e shumta që kishin lidhje me këtë grup. Për shembull në Elbasan hasim në emra vendesh apo objektesh si pusi i tabakëve, shatervani i tabakëve, teqeja apo tyrbja e tabakëve, sheshi i tabakëve etj.⁴⁶ Madje, vetë njëra ndër lagjet më të mëdha të qytetit kishte emrin Tabakhane, aspekt i cili e tregon më së miri rëndësinë dhe peshën që ky esnaf kishte në Elbasan.

⁴⁵ Në sherijet e Elbasanit hasim në shumë dokumenta ku bëhen dhurime në favor të vakëfeve të korporatave. Këtu mund të përmendim disa raste si dhurimi i shpataxhi Hysenit i cili kishte vdekur dhe kishte lënë në favor të vakëfit të korporatës së shpatandreqësve 500 akçe. Shih: *AQSH*, F. 129, D. 2, fl. 3; Një grua e quajtur Zejnepe, e bija e Jusuf Bakallit ka lënë vakëf një shumë të madhe prej 100.000 akçesh, një pjesë të së cilës ajo ia lë korporatës së këpuçarëve. Shih: *AQSH*, F. 129, D. 8, fl. 16.

⁴⁶ *AQSH*, F. 129, D. 8, fl. 5; Z. Shkodra, *Esnafet shqiptare...*, f. 209.

Një aspekt tjetër i institucionit të vakëfeve të esnafëve është dhe fakti se këto të fundit mund ti përdornin ato edhe në formën e një “banke” nga e cila mund të tërhiqnin kapitalin për të cilin kishin nevojë për ta kthyer këtë sërish më vonë. Në këtë mënyrë esnafët e kishin më të lehtë të investonin në blerjen e produkteve apo pronave të ndryshme për ta rritur kapitalin e tyre. Janë të shumta rastet kur esnafët marrin para nga vakëfi i korporatës në të cilën ato bënin pjesë. Për shembull, në një dokument të vitit 1606 bëhet fjalë për një banor të Elbasanit i quajtur Hasan Çelebi i cili kishte marrë nga vakëfi në të holla i organizatës së takjexhive 3000 akçe me qera për ti paguar nga 100 akçe në vit.⁴⁷

Duke patur parasysh karakterin e fortë ekonomik të Elbasanit vlen të veçohet se edhe ky aspekt pasqyrohet në pronat që vakëfet kishin. Kështu, regjistrat e gjykatave tregojnë se një pjesë e konsiderueshme e pronave të lëna në formën e vakëfit konsistonin në objekte që kanë të bëjnë me tregtinë ku shumica janë dyqane, prona të përbashkëta të korporatës por edhe objekte të tjera si hane apo hamame. Për shembull vakëfi i një personi të quajtur Husrev nga qyteti i manastirit kishte patur nën pronësinë e tij një hamam në pjesën e tregut në Elbasan. Regjistrat tregojnë se pas nxjerrjes në ankand hamami është marrë nga një person i quajtur Hysen me profesion hamamxhi për një vit me qera kundrejt shumës së 1800 akçeve.⁴⁸

Institucioni i vakëfit në periudhën osmane hasej në të gjitha pjesët e shtetit osman dhe nuk kishte ndonjë limitim në mënyrën e të dhuruarit. Kështu një funksionar i cili jetonte në Stamboll ose në ndonjë pjesë tjetër të perandorisë mund të linte vakëf në vendlindjen e tij apo në vendin ku ushtronte funksionin e tij si zyrtar. Një figurë që mund të tregohet si shembull në këtë kontekst është edhe arkitekti i njohur osman me origjinë shqiptare Kasemi i cili ka ndërtuar vepra të rëndësishme arkitekturore si në trojet shqiptare ashtu edhe në pjesë të tjera të perandorisë. Kështu, mësojmë se arkitekt Kasemi në vitin 1641 ka kthyer në vakëf çifligje, banja, çezma, e prona të ndryshme në sanxhakët e Vlorës dhe të Elbasanit.⁴⁹ Po ashtu, Hajdar pasha, një funksionar i lartë në ushtrinë osmane me origjinë nga një fshat i Elbasanit ka lënë një vakfije me anë të

⁴⁷ *Po aty*, F. 129, D. 2, fl. 7.

⁴⁸ *Po aty*, F. 129, D. 5, fl. 25.

⁴⁹ *Historia e Popullit Shqiptar...*, f. 523.

së cilës ai ndërton në fshatin e lindjes një xhami dhe një shkollë. Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre ai ka ndërtuar edhe një vakëf.⁵⁰

Një fushë tjetër e rëndësishme tek e cila shkonin kontributet dhe të ardhurat që fitonin nga vakëfet ishin edhe institucionet e besimit. Duke patur parasysh influencën që besimi kishte në jetën personale dhe komunitare të kësaj periudhe vërejmë se në vakfijet e shumta dhurohet edhe për këto institucione ku veçanërisht spikasin teqet. Në vetvete ky element mbart dy shpjegime. I pari ka të bëjë me përhapjen e rrymave mistike islame në Elbasan. Ndërsa aspekti i dytë ka të bëjë me impakti dhe roli që baballarët e teqeve kishin në hierarkinë e korporatave të ndryshme që ekzistonin në këtë qytet. Për shembull, një lëkureregjës me emrin Meto në vitin 1667 mësojmë të ketë lënë një vakëf të konsiderueshëm në materiale dhe të holla. Ndër kushtet e tij për përdorimin e të fitimeve nga këto është që një pjesë e të ardhurave ti jepen teqes së tabakëve.⁵¹ Po për të njëjtën teqe Muhamedi nga lagja Tabakhane në vitin 1690 do të lërë një vakëf prej 6000 akçesh, të ardhurat e të cilave do të përdoren për të varfërit e kësaj teqeje.⁵²

Duke u nisur nga të dhënat e mësipërme vërejmë se vakëfet në qytetin e Elbasanit gjatë shek. XVII. paraqesin disa komponentë të rëndësishëm që luanin rol në zhvillimin e jetës sociale, kulturore dhe ekonomike të qytetit. Roli social i vakëfeve konsistonte në ardhjen në ndihmë të shtresave në nevojë përmes shërbimeve që vakëfet jepnin. Ndërtimi ose mirëmbajtja e rrugëve, çezmave, shkollave dhe objekteve të kultit u jepnin mundësi banorëve të qytetit të përfitonin nga shërbimet e dhëna përmes tyre. Nga ana tjetër shtresa e pasur solidarizohej në jetën qytetare me anë të dhurimeve në formën e pasurive të patundshme apo atyre financiare duke hapur kështu edhe vende të reja pune duke patur parasysh faktin se ishin njerëzit ato që do të punonin për mirëmbajtjen dhe mirëfunksionimin e vakëfit. Padyshim që një rol të rëndësishëm vakëfet luajtën edhe zhvillimin ekonomik të qytetit dhe të esnafëve në veçanti. Vakëfet e secilit grup esnafor në njërën anë përdoren për ndërtimin e veprave në të mirë të shoqërisë por nga ana tjetër funksiononin edhe si kapital i përbashkët ku esnafët mund të shkonin e të tërhiqnin të holla në

⁵⁰ *AQSH*, F. 129, D. 26, fl. 20.

⁵¹ *Po aty*, F. 129, D. 2, fl. 12-13.

⁵² *Po aty*, F. 129, D. 8, fl. 2.

raste nevojë. Të pasurit e një sigurie financiare i stimulonte pjesëtarët e esnafëve të investonin në zgjerimin e aktiviteti të tyre.

Përfundim

Si përfundim mund të thuhet se edhe pse u kthye në qytet nga ana e osmanëve në një periudhë të vonë krahasuar me qytetet e tjera përreth, Elbasani arriti në një kohë shumë të shkurtër të kthehej në njëra ndër qendrat më kryesore shqiptare të kohës. Pozicioni gjeografik, afërsia me detin dhe gjeografia e përshtatshme ndikuan që qyteti të zhvillohej në aspektin demografik, ekonomik e kulturor. Teksa vijmë në shek. XVII Elbasani i kishte lënë në hije të gjitha qytetet përreth. Veçanërisht sistemi i esnafëve dhe ekonomia që gjenerohej në këtë pikë të rëndësishme e bënte Elbasanin që ti tejkalonte kufijtë e hapësirave të qyteteve shqiptare.

Për të analizuar zhvillimin kaq të shpejtë të qytetit është e nevojshme të nxirren në pah shkaqet që ndikuan në kthimin e qytetit në pikë referimi. Përveç shkaqeve të cituara më sipër janë edhe dinamikat e brendshme të qytetit të cilat i dhanë Elbasanit shtytjen për të përparuar si qendër urbane. Sigurisht që këtu një rol të rëndësishëm luajtën edhe vakëfet të cilat ishin shtrirë në të gjitha venat e shoqërisë së qytetit. Shërbimet e vakëfeve ndaj shtresave në nevojë dhe impakti i tyre në zhvillimin e korporatave ekonomike i bëri vakëfet të kishin një rol thelbësor në shkëlqimin e qytetit gjatë kësaj periudhe.

S u m m a r y

THE ROLE AND FUNCTION OF WAFQ'S IN THE CITY OF ELBASAN DURING XVII CENTURY

The city of Elbasan was established by the Ottoman army during the second siege of Kruja, year 1466. The documents show that the castle was built in a short period of one month. Considering its strategic position the city became one of the most important centers of Central Albania. In the XVII'th century Elbasan figures as a developed city an a lot of components such demographic, economic, administrative and cultural aspects.

There are some elements which affected the economic and social growth of the city. One of them is the economic network that consisted in the trade and the system of artisans. Thus the economic growth and the enrichment of the

social classes pushed them to invest and contribute in social causes. The wafq's were a direct result of the contribution of rich classes and noble families in the building of public service institutions for certain classes. The wafq's also had a big impact in the development of the economic system of the city. This element stressed by a large number of documents of Sijilat-i Shariyah found in the Archive of State of Albania.